



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

RAPORT

MBI

**MONITORIMIN E FONDEVE BUXHETORE,
PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2025,
PËR KOLEGJIN E POSAÇËM TË APELIMIT**

SHKURT 2026

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje
2.	Raporti i shpenzimeve faktike për vitin 2025
2.1	Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit
	Analiza financiare analitike
2.1.1	Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)
2.1.2	Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)
2.1.3	Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)
2.1.4	Shpenzimet kapitale (231)

1 HYRJE

Kolegji i Posaçëm i Apelimit është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si një ndër tri institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kolegji si organi i vetëm gjyqësor, gjatë mandatit të tij 9-vjeçar, ka kompetencë të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për çështjet e rivlerësimit, si dhe juridiksion disiplinor, në përputhje me përcaktimet e nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Referuar pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si Kolegj i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3, të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Për të përmbushur detyrat e ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, Kolegji mbështetet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë, dhe mandati i Kolegjit, referuar pikës 8, të nenit 179/b, të Kushtetutës, përfundon në datën 17.06.2026.

Misioni i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është: *“Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”*. Kolegji i Posaçëm i Apelimit funksionon me një program të vetëm buxhetor, me emërtesën: “Veprimtaria e Apelimit të Rivlerësimit Kalimtar”.

Përshkrimi i programit: *“Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”*.

Qëllimi i politikës së programit: *“Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”*.

Objektivi 1 - *“Të shqyrtojë çështjet e ankimuara nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”*.

Treguesi i performancës, i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektiv, është: *“Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuara”*.

Për përmbushjen e misionit të tij, për vitin 2025, Kolegji ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 115, datë 03.12.2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet nënligjore në fushën e menaxhimit financiar dhe buxhetor.

Ky dokument përfaqëson Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar, që ka në fushën e përgjegjësisë Kolegji i Posaçëm i Apelimit (Kolegji), duke ofruar informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2025. Monitorimi i zbatimit të buxhetit për këtë periudhë përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të

performancës me ata të planifikuar. Me qëllim për të kontribuar në përmbushjen e misionit dhe objektivave të institucionit, buxheti i Kolegjit është mbështetur në udhëzimet standarde të hartimit të buxhetit mbi bazë të treguesve të performancës, por gjithashtu edhe në monitorimin e realizimit buxhetor mbështetur mbi ata tregues të planifikuar gjatë hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.

2 RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE PËR VITIN 2025

Buxheti i Kolegjit është miratuar me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, ku në total rezulton të jetë miratuar si plan fillestar një vlerë prej 288 milionë lekësh. Këto burime financiare, Kolegji i ka përdorur në funksion të përmbushjes së plotë të detyrimeve të miratuara me ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe vendimmarrjes së Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 01, datë 13.01.2025, për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2025. Në kërkesat buxhetore për vitin 2025, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka përcaktuar si produkt kryesor për realizimin e objektivit: “Të shqyrtojë çështjet e ankimuara nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”. Deri më datë 31.12.2025 janë shqyrtuar 97 çështje.

Situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin, për periudhën janar – dhjetor 2025, paraqitet si më poshtë:

RAPORTI I SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE SIPAS LLOGARIVE EKONOMIKE

Në mijë lekë

Art.	Emërtimi	Fakt 2024	Buxhet vjetor fillestar 2025, sipas ligjit nr. 115/2024	Buxhet vjetor i rishikuar 2025	Fakti 12-mujor i vitit 2025	Realizimi në % mbi buxhetin vjetor
600	Paga	255,274	231,939	245,639	233,676	95%
601	Sigurime shoqërore	20,533	30,421	22,221	21,902	99%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	19,030	23,640	20,840	20,777	100%
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	1,009	0	1,250	998	80%
231	Shpenzime kapitale me financim të brendshëm	1,289	2,000	2,000	890	45%
	Total	297,135	288,000	291,950	278,244	95%

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË PLANIFIKUARA KUNDREJT REALIZIMIT TË VITIT 2025

Duke marrë në analizë peshën e shpenzimeve sipas llogarive ekonomike mbi totalin e buxhetit vjetor të Kolegjit, pjesën më të madhe të planit të shpenzimeve buxhetore e zë llogaria “Paga të personelit”, me rreth 84%, llogaria “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, me rreth 7.9%, më pas llogaria “Mallra dhe shërbime të tjera”, me rreth 7.5%, llogaria “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” me rreth 0.4%, ndërkohë që llogaria “Shpenzime kapitale” zë një peshë më të vogël, 0.3%.

Duke u mbështetur mbi veprimtarinë bazë të institucionit, kjo shpërndarje e planit të shpenzimeve buxhetore lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punës së Kolegjit. Nëse do të marrim në analizë peshën e llogarive ekonomike, ndërmjet atyre të planifikuara dhe të realizuara, evidentohet një ruajtje e peshës së këtyre shpenzimeve, si në buxhetin e planifikuar, ashtu edhe në atë të realizuar për periudhën e 12-mujore të vitit 2025.

Gjatë kësaj periudhe është synuar përdorimi me eficiencë dhe efektivitet maksimal i burimeve financiare, në zbatim të legjislacionit në fuqi, dhe në vijim synohet konsolidimi financiar dhe administrativ i institucionit, me qëllim realizimin e treguesve të performancës, të përcaktuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025 – 2027.

2.1 INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Buxheti i miratuar sipas ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, është 288.3 milionë lekë dhe gjatë 12-mujorit ka pasur ndryshime në buxhetin e miratuar, si rezultat i Aktit Normativ nr 10 datë 8.10.2025 dhe rialokime fondesh brenda buxhetit të miratuar, si më poshtë:

- Transferim fondi sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 3280/1, datë 21.02.2025, protokolluar në Kolegj me nr. 260/1 prot., datë 24.02.2025, për pakësim në artikullin 602 dhe shtesë në artikullin 606, në vlerën 1 milion lekë.
- Transferim fondi sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 13064/1, datë 17.09.2025, protokolluar në Kolegj me nr. 932 prot., datë 18.09.2025, për pakësim në artikullin 601 dhe shtesë në artikullin 600, në vlerën 8.2 milionë lekë.
- Shtesë fondi në artikullin 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime”, bazuar në Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, në vlerën 3.7 milionë lekë.
- Transferim fondi sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 16321/1, datë 14.11.2025, protokolluar në Kolegj me nr. 1062/1 prot., datë 16.12.2025, nga artikulli 602 tek artikulli 600, në vlerën 5.5 milionë lekë.

RISHIKIMI I FONDEVE BUXHETORE

Në mijë lekë

Përshkrimi	600 (Paga)	601 (Sigurime shoqërore)	602 (Shpenzime operative)	606 (Transf. buxhetore familjare)	231 (Investimet)	Totali
Plani fillestar	231,939	30,421	23,640	250	2,000	288,250
Transferime sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 3280/1, datë 21.02.2025	-	-	(1,000)	1,000	-	-
Transferim sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 13064/1, datë 17.09.2025,	8,200	(8,200)	-	-	-	-
Akti normativ nr.10 datë 08.10.2025	-	-	3,700	-		3,700
Transferim sipas shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 16321/1, datë 14.11.2025	5,500	-	(5,500)	-	-	-
PLANI VJETOR ME SHTESA	245,639	22,221	20,840	1,250	2,000	291,950

ANALIZA FINANCIARE ANALITIKE

2.1.1 Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, kanë qenë në vlerën 232 milionë lekë. Gjatë vitit 2025 janë kryer shtesa nga rialokimet në vlerën 13,7 milionë lekë, ndërkohë që plani i rishikuar rezulton në vlerën 245,6 milionë lekë. Buxheti është realizuar në vlerën 233.6 milionë lekë ose rreth 95% të planit vjetor. Ky buxhet është përdorur për mbulimin e detyrimeve ligjore në fushën e pagave dhe sigurimeve shoqërore, për Gjyqtarët, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, si dhe punonjësit administrativë të Kolegjit.

Numri i punonjësve në organikë, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, të ndryshuar, është 67 punonjës, ndërkohë që numri mesatar faktik i punonjësve për 12-mujorin e vitit 2025, është 65 punonjës.

Me VKM-në nr. 19, datë 09.01.2025, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore”, u miratua një numër shtesë prej 4 punonjësish me kontratë të përkohshme, me kohë të pjesshme pune (6 orë/ditë), prej të cilëve u punësuan 3 punonjës në pozicionet: specialist sekretarie gjyqësore, specialist protokoll/arkiv dhe shofer/korrier.

2.1.2 Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Fondet e miratuara në fillim të vitit, me ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, janë në vlerën 30.4 milionë lekë. Gjatë vitit 2025 janë kryer pakësime nga rialokimet në vlerën 8.2 milionë lekë, ndërkohë që plani i rishikuar rezulton në vlerën 22,2 milionë lekë. Ky buxhet është realizuar në vlerën 21.9 milionë lekë ose rreth 99% e planit të vitit 2025. Fondi për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe, si rrjedhojë, argumentet që lidhen me fondin e pagave, vlejné edhe për këtë zë buxhetor.

2.1.3 Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihen shpenzimet për materiale dhe shërbime të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë operacionale. Shpenzimet për këtë zë zënë 7.5% të shpenzimeve totale vjetore. Fondet e miratuara në fillim të periudhës për këtë zë, me ligjin nr. 15/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, kanë qenë në vlerën e 23.6 milionë lekë dhe rishikimet e buxhetit në këtë zë konsistojnë në:

- Transferimin e një fondi në vlerën 1 milion lekë nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 606, “Transferata për buxhetet familjare dhe individët”, për mbulimin e shpenzimeve telefonike, për kontratat individuale të Gjyqtarëve dhe Këshilltarëve të Kolegjit, bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020, dhe në Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020.
- Transferimi i një fondi prej 5,5 milionë lekësh në artikullin 600, “Shpenzimet për paga”, për mbulimin e detyrimeve në fushën e pagave për punonjësit e Kolegjit.
- Shtesë fondi, bazuar në Aktin Normativ nr. 10, datë 08.10.2025, në vlerën 3.7 milionë lekë

Buxheti i rishikuar në shpenzime operative, për vitin 2025, rezulton në vlerën 20.8 milionë lekë, është realizuar në vlerën 20.78 milionë lekë, ose rreth 99.6% të planit vjetor.

Në mënyrë të detajuar, shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim.

Në lekë			
Artik.	Struktura e llogarive	Plan vjetor 2025	Fakt 12-mujor
602	<i>Mallra dhe shërbime të tjera</i>	20,840,000	20,776,653
1	Materiale zyre dhe të përgjithshme	780,000	775,430
2	Materiale dhe shërbime speciale	900,000	897,572
3	Shërbime nga të tretë	3,305,000	3,304,756
4	Shpenzime transporti	310,000	308,727
5	Shpenzime udhëtimi	540,000	532,386
6	Mirëmbajtje të zakonshme	575,000	570,431
7	Shpenzime për qiramarrje	530,000	526,000
8	Ekzekutim vendimi gjyqësor	3,700,000	3,699,363
9	Shpenzime të tjera operative	10,200,000	10,161,988

Gjatë periudhës 12-mujore janë kryer pagesa për të shlyer detyrimet bazuar në kontratat dhe faturat, sipas procedurave përkatëse. Shpenzimet janë realizuar për pagesat e detyrimeve utilitare dhe detyrime prioritare: si energji elektrike, ujë, shërbime postare, si dhe taksa blerje karburanti, shlyerja e detyrimeve kontraktuale, prokurimet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

2.1.3.1 Materiale zyre dhe të përgjithshme

Në këtë nënartikull buxhetor përfshihen shpenzimet materiale për: kancelari/letër, materiale higjieno-sanitare, materiale elektrike dhe artikuj si këto. Plani vjetor i buxhetit i rishikuar për këtë zë, është 780 mijë lekë, nga i cili është përdorur një fond prej rreth 775 mijë lekësh. Në këtë zë peshën kryesore e zë pagesa për blerje letër dhe kancelari, në vlerën 465 mijë lekë dhe blerje materiale pastrimi, në vlerën 296 mijë lekë.

2.1.3.2 Materiale dhe shërbime speciale

Në këtë nën artikull bëjnë pjesë shpenzimet lidhur me abonimet në shtypin e shkruar, regjistra specifike të protokollit, kodekse, uniforma për seancat gjyqësore, dezinfektim ambientesh, pagesë tarife për OBP etj. Nga 900 mijë lekë të planifikuara për vitin 2025, janë përdorur rreth 898 mijë lekë. Në këtë zë, peshën kryesore e zë pagesa e tarifës për kryerje procedure prokurimi nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me vlerë 301 mijë lekë, blerje ujë i pijshëm, me vlerë 285 mijë lekë, publikime në shtypin e shkruar, në vlerën 202 mijë lekë.

2.1.3.3 Shërbime nga të tretë

Në këtë nën artikull bëjnë pjesë shpenzimet utilitare, si: energji elektrike, furnizim me ujë, shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar), telefoni fikse dhe fondet e parashikuara janë realizuar rreth 100%. Peshën kryesore në këtë zë e mban nën zëri “energji elektrike” me 1.6 milionë lekë (47% të totalit të nënartikullit), Shërbim printimi në vlerën 798 mijë lekë (24 % të totalit të nënartikullit) dhe shërbime të telefonisë celulare në vlerën 643 mijë lekë (19% të totalit të nënartikullit).

2.1.3.4 Shpenzime transporti

Fondi për këta zëra për periudhën 12-mujore është përdorur në varësi të nevojave për mbajtjen në gjendje të mirë pune dhe sigurimin e vendit të parkimit të automjetit. Fondi i planifikuar është 310 mijë lekë dhe realizimi është në vlerën 309 mijë lekë ose rreth 100%. Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzimet që lidhen me pjesët e këmbimit të makinave, goma, bateri, karburant, vend parkimi për automjetin e Kolegjit, si dhe siguracioni i detyruar i automjetit. Peshën kryesore në këtë zë e mban nën zëri “Parkim për automjetin e institucionit”, i realizuar me lidhjen e kontratës, në vlerën 198 mijë lekë (64% të totalit të nënartikullit).

2.1.3.5 Shpenzime udhëtimi

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit. Planifikimi vjetor për këtë zë është 540 mijë lekë dhe realizimi 12-mujor është 532 mijë lekë. Ky fond është përdorur për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit të Drejtuesit të institucionit, si dhe mbulimin e shpenzimeve për dieta brenda vendit të personelit, për zhvillimin e analizës së punës, me temë: “17 qershor 2017 – 17 qershor 2025, 8 vite të procesit të rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, objektivat dhe sfidat e vitit përmbyllës”.

2.1.3.6 Mirëmbajtje të zakonshme

Në këtë nën artikull janë planifikuar shpenzime për mirëmbajtjen e sistemeve/pajisjeve TIK, të sistemit elektrik, programit financiar “Financa 5”, si dhe mirëmbajtje të mjeteve të transportit. Buxheti vjetor i planifikuar në këtë zë është 575 mijë lekë dhe realizimi është 570 mijë lekë. Janë kryer procedurat e prokurimit për rinovim, licenca *Mikrosoft Office, FireWall, Zoom Meeting*, në vlerën 306 mijë lekë, mirëmbajtjen e pajisjeve TIK, në vlerën 162.5 mijë lekë dhe mirëmbajtje mjete transporti, në vlerën 82 mijë lekë.

2.1.3.7 Shpenzime për qiramarrje

Në këtë nënartikull janë kryer shpenzime për qiranë e ambienteve shtesë, sipas kontratës nr. 997/3 prot., datë 26.09.2024, për periudhën janar – prill 2025, datë në të cilën u ndërpre kjo kontratë, si dhe qira ambienti për zhvillimin e analizës së punës, me temë: “17 qershor 2017 – 17 qershor 2025, 8 vite të procesit të rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, objektivat dhe sfidat e vitit përmbyllës”. Plani vjetor për këtë zë shpenzimi ka qenë në vlerën 530 mijë lekë dhe realizimi 526 mijë lekë.

2.1.3.8 Shpenzime të tjera operative

Në këtë nënartikull bëjnë pjesë shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës, shpenzime për taksa të ndryshme. Në këtë zë, peshën kryesore e zënë prokurimet me objekt:

- “Sigurimi i shëndetit për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të Gjyqtarëve, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimi i pasurisë”. Për këtë procedurë, bazuar në marrëveshjen kuadër nr. 2206/5 prot., datë 22.08.2025, është nënshkruar kontrata me nr. 645/19 prot., datë 16.10.2025, me operatorin ekonomik fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, “EUROSIG” ShA dhe “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” ShA, për vlerën 7.9 milionë lekë, me afat 17 tetor 2025 – 17 qershor 2026.

- “Sigurimi i jetës për Gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, personat e lidhur të Gjyqtarëve, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive”. Për këtë procedurë, bazuar në marrëveshjen kuadër nr. 3905/6 prot., datë 12.12.2025, është nënshkruar kontrata nr. 948/15, datë 18.12.2025 me operatorin ekonomik fitues të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “INSIG JETË” ShA dhe “SIGAL LIFE INSURANCE GROUP” ShA, për vlerën 1,849,800 (një milionë e tetëqind e dyzet e nëntë mijë e tetëqind) lekë, me afat 20 dhjetor 2025 – 17 qershor 2026.

2.1.3.9 Transferta për buxhetet familjare dhe individët (llogaria ekonomike 606)

Buxheti vjetor i detajuar në këtë zë është në vlerën 1.3 milionë lekë dhe realizimi në vlerën 998 mijë lekë ose rreth 80% e planit vjetor. Në këtë grup përfshihet fondi për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare për Gjyqtarët, Këshilltarët e Kolegjit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe dy Drejtorë Drejtorie, sipas përcaktimit në VKM-në nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 28, datë 21.12.2020, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 05.02.2021.

Me shkresën nr. 3280/1 prot., datë 21.02.2025, të Ministrisë së Financave është kryer transferimi i fondit prej 1 milion lekë nga artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, në artikullin 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”.

2.1.4 Shpenzimet kapitale (231)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2025 në investime është 2 milionë lekë. Këto fonde u parashikuan për plotësimin e nevojave të institucionit për pajisje kompjuterike, në vlerën 1 milion lekë dhe pajisje e mobilie zyre, në vlerën 1 milion lekë. Sa i takon realizimit të zërave në investime ato rezultojnë si më poshtë:

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje elektronike”, është realizuar në vlerë totale 698 mijë lekë
- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje dhe mobilie të ndryshme” me vlerë 192 mijë lekë.

Fondi në investime është përdorur gjatë vitit 2025 për blerjen e pajisjeve dhe mobilieve të zyrave, të nevojshme deri në përfundim të mandatit kushtetues të Kolegjit.

Në përfundim të sa më sipër, bashkëlidhur gjeni anekset për Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, për periudhën janar – dhjetor të vitit 2025.

Duke ju falënderuar për vëmendjen,

Nëpunës Zbatues

Valbona Leka

Nëpunës Autorizues

Alketa Çeli